

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

- a. Formulari i Ofertës, sipas Shtojces 1;*
- b. Deklaratën për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 1/1 c. Sigurimi i ofertes, (nëse është i zbatueshëm) sipas Shtojcës 3;*
- ç. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;*
- d. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit, sipas Shtojcës 6;*
- dh. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojces 7/1;*
- e. Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

**2. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1 Kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomikë:**

Sipas Shtojces 8, pika 1.

### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar i operatorëve ekonomikë:**

- Kopje të vërtetuar të bilanceve, të audituara nga auditues ligjor, të konfirmuara nga autoritetet perkatese (Administrates Tatimore) të tre viteve të fundit (2016, 2017, 2018).
- Vërtetim xhiroje vjetore nga Administrata Tatimore, për tre vitet e fundit (2017, 2018, 2019), ku xhiroja mesatare e tre viteve të mos jetë me vlerë më të ulët se 40% e vlerës së fondit limit.

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

#### **1. Përvojat e mëparshme:**

Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë realizuar gjatë tre viteve të fundit kontrata të ngjashme me një vlerë prej 40% të fondit limit.

-Për kontratat e realizuara me institucione publike duhet të paraqesë vërtetimin e realizimit me sukses ose/dhe fatura tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

-Për kontratat e realizuara me subjekte private duhet të paraqesë faturat tatimore te shitjes ku te shenohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

## **2. Përsa i përket aftësisë teknike profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale:**

a) Ofertuesi duhet të zotërojë certifikatat:

- ISO 9001:2015 Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë
- ISO 14001:2015 Sistemi i Menaxhimit të Mjedisit
- BS OHSAH 18001:2015 Sistemi i Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë.

b) Ofertuesi duhet të zotërojë licencat:

- Licencë në Projektim Kat. 4, pika e, f, / Kat.5 pika b, g / Kat 8, pikat a, b, c, d, e.
- License ne mbikëqyrje dhe kolaudim të punimeve të zbatimit, kategorite NP-1, NP-2, NP-7a, NP-7b dhe NS-12
- Licencë për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Licencë Kodi III.2.A (1+2).

### **2.3 Personeli i nevojshëm**

a) Per kryerjen e shërbimit O.E. ofertues, duhet të paraqesë një listë të personelit kryesor të nevojshëm, shoqëruar me këto dokumenta: CV-të e tyre, diploma dhe kontratë.

Ne stafin e paraqitur O.E. duhet te kete jo me pak se:

- 2 (dy) inxhinierë mekanikë,
- 2 (dy) inxhinierë të diplomuar në fushën e nxjerrjes dhe/ose shfrytëzimit të naftës dhe gazit,
- 3 (tre) inxhinierë ndërtimi,
- 4(katër) inxhinierë gjeodet,
- 4 (kater) inxhinierë mjedisi,
- 2 (dy) ekspertë të diplomuar në gjeodezi, gjeomatikë, gjeoinformatikë, me eksperincë dhe/ose trajnime në fushën e GIS, (Sistemeve të Informacionit Gjeografik)
- 1 (nje) inxhinier elektrik,
- 2 (dy) inxhinierë IT (Teknologji Informacioni) - do të pranohen si të tillë ekspertë të diplomuar në Informatikë, Teknologji Informacioni, Shkenca Kompjuterike ose Inxhinieri Elektronike.
- 1 (nje) inspektor për provat pa shkatërrim (NDT) per matjet me ultratinguj.  
(Per inspektorin NDT të paraqitet certifikata e kualifikimit të personelit sipas standardit  
SSH EN ISO 9712 - Kualifikimi dhe certifikimi i personelit NDT)
- 1(një) ekspert te trajnuar dhe çertifikuar për shëndetin dhe sigurine ne punë.
- 1(një) ekspert i licensuar per Vlerësim të Pasurive të Paluajtshme të llojit Truall dhe Ndërtesë, Shkalla II
- 1(një) ekspert i licensuar per Vlerësim të Pasurive të Paluajtshme në fushën "Linja teknologjike, makineri e pajisje", Shkalla II
- 1(një) ekspert te pajisur me "Çertifikate" te leshuar nga Ministria e Mjedisit, per hartimin e raporteve te vleresimit te ndikimit ne mjedis, per te kryer auditime mjedisore, per hartimin e

ekspertizave për probleme mjedisore dhe thirrje si ekspert për të vlerësuar një raport të ndikimit në mjedis ose rezultatet e një auditimi.

b) Operatori ekonomik duhet të paraqesë një numër mesatar të punonjësve të siguruar gjatë 6 (gjashtë) muajve të fundit të vitit 2019, jo më pak se 50 (pesëdhjetë).

Për këtë qëllim operatori ekonomik duhet të paraqesë:

1. Vërtetim për numrin e punonjësve nga Administrata Tatimore për periudhën 07/2019 - 12/2019 të konfirmuara në formë elektronike nga administrata tatimore;
2. Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore për periudhën 07/2019 - 12/2019 të konfirmuara në formë elektronike nga administrata tatimore.

#### **2.4 Disponimi i mjeteve/pajisjeve të mëposhtme:**

*Si dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik, kandidati/ofertuesi duhet të vërtetojë se disponon:*

<b>Nr</b>	<b>Mjetet</b>	<b>Pronesia</b>	<b>Sasia</b>	<b>Specifikimet</b>
<b>A</b>	<b>MjeteTransporti</b>			
<b>1</b>	Automjete ATP	Në pronësi ose me qira	Copë 4	

B	Aparate			
1	GPS Rover	Në pronësi ose me qira	Copë 4	
2	Stacion Total (Total Station)	Në pronësi ose me qira	Copë 1	Saktësia matjes së këndeve: 3", Saktësia e matjes së distancave: 1.5mm+2ppm; Gjatesia e matjes pa reflektor: 500m
3	Drone	Në pronësi ose me qira	Copë 2	Saktësia: V:0.5m me GPS H:1.5m me GPS; Koha e fluturimit me një bateri: 30min
4	Kamera Endoskopike	Në pronësi ose me qira	Copë 1	Gjatesia Fokale: 0.25" deri në infinit, rregullim manual;
5	Instrument mates me ultratinguj të trashësisë së spesorit të tubacioneve	Në pronësi ose me qira	Copë 2	
6	Terrrometer për matjen e rezistencës së tokezimit	Në pronësi ose me qira	Copë 2	
7	Mates presioni	Në pronësi ose me qira	Copë 1	Shkalla presionit 0-100 bar; saktësia <1%,
8	Kamera Termike për matje të temperaturës	Në pronësi ose me qira	Copë 1	Shkalla temperaturës -10°C - 100°C
9	Detektues tubacionesh në thellësi "Pipeline / Metal Detector"	Në pronësi ose me qira	Copë 2	- Thellesi detektimi min: 1.5m - Kohe skanimi min: 4 ore
10	Licence të Autocad ose Ekuivalent	Në pronësi	Copë 2	Licence të Autocad Map ose Ekuivalent
11	Licence të sisteme të teknologjisë GIS	Në pronësi	Copë 2	Licence të Esri ArcGIS ose Ekuivalent

**Kërkohe:** Për pajisjet Kamera termike, Mates Presioni, Terrrometer për matjen e tokezimit, Instrument për mates me Ultratinguj, Stacion Total dhe GPS të paraqiten certifikatat e kalibrimit të pajisjeve nga Laboratore Kalibrues.

**Pronësia** e mjeteve të mesiperme të vertetohet si më poshtë:

Ofertuesi duhet të paraqesë për automjetet të cilat janë në pronësi, lejen e qarkullimit të mjetit rrugor, siguracion të vlefshëm, akt kolaudimi të vlefshëm, taksat vjetore.

Për aparatet Ofertuesi duhet të paraqesë kontratë noteriale të blerjes (nëse ka) të shoqëruar me fatura tatimore të blerjes ose dokument zhdoganimi të aparatit.

**Pranohet:**

Marrja me qira ose huapërdorje për automjetet duke paraqitur kontratën e qirasë ose huapërdorjes, lejen e qarkullimit të mjetit rrugor, siguracion të vlefshëm, akt kolaudimi të vlefshëm, taksat vjetore.

Marrja me qira ose huapërdorje për aparatet e kërkuara. Ofertuesi duhet të paraqesë kontratë e qirasë ose huapërdorjes të shoqëruar me fatura tatimore të blerjes ose dokument zhdoganimi të aparatit nga subjekti që i ka ato në pronësi.

Të gjitha mjetet dhe aparatet e kërkuara të jenë të shoqëruara me foto.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim

